



VENDIM

Nr. 34, datë 21.2.2020

MBI MODIFIKIMIN E ANEKSIT TË LICENCËS SË SHOQËRISË “HEC-i BISHNICA 1, 2” SHPK, NR. 95, SERIA PV10K, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 23, DATË 23.3.2010, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC-i BISHNICA 1, 2” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa” a” dhe nenit 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, dhe nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.2.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 30/6 prot., datë, 12.2.2020, “Për modifikimin e licencës së shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., nr. 95, seria PV10K, dhënë me vendimin e Bordit të komisionarëve të ERE-s nr. 23, datë 23.3.2010, për prodhimin e energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar”,

konstatoi se:

- Me shkresën protokolluar në ERE nr. 738 prot., datë 13.11.2019, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për modifikim licence.

- Shoqëria “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 95, seria PV10K, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 23.3.2010, për prodhimin e energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 14, datë 23.1.2020, filloi procedurën për modifikimin e licencës nr. 95, seria PV10K, dhënë shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 23.3.2010, i cili konsistonte në ndryshimin e njërive gjeneruese:

- Numri i njërive gjeneruese:

Është: 2 (njësi), me kapacitet të instaluar 2.5 mw.

Bëhet: 3 (njësi), me kapacitet të instaluar 2.5 mw.

- Në vijim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 14, datë 23.1.2020, u krye njoftimi në medien e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në rregullore nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta.

- Me shkresën protokolluar në ERE me nr. 389/1 prot., datë 5.2.2020, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e konstatuar të munguar.

- Aplikimi i shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës: plotësuar. Shoqëria deklaron se shtimi i agregatit është vendosur për arsye të vështirësisë që ka hasur HEC-i në plotësimin e detyrimeve kontraktuale për prodhimin e energjisë elektrike.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence: plotësuar. Me shkresën nr. 389/1 prot., datë 5.2.2020, shoqëria ka depozituar në ERE vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., të datës 5.2.2020, ku është vendosur të miratohet shtesa e një agregati të ri.

- Neni 15, pika 4, germa “c”: miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin



nga organe të tjera: plotësuar. Shoqëria ka depozituar në ERE shkresën e MIE-s nr. 10416/3 prot., datë 24.9.2018, në të cilën citohet se AKBN-ja e ka vlerësuar të pranueshëm vendosjen nga ana e shoqërisë të një agregati shtesë në hidrocentralin “Bishnica 2”, sipas kushteve të cituara në shkresën e AKBN-së nr. 6740/1 prot., datë 30.8.2019.

- Neni 15, pika 4, germa “d”: ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi: plotësuar. Shoqëria ka deklaruar se vendosja e këtij agregati shërben për të optimizuar skemën me qëllim realizimin e prodhimit të energjisë elektrike, siç parashikuar në kontratën e koncesionit dhe për të shfrytëzuar funksionimin e tij në rastin e periudhave me prurje të ulëta.

- Neni 15, pika 4, germa “e”: të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE: plotësuar. Rezulton se shoqëria nuk është debitore sa u përket pagesave të rregullimit në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e aneksit të licencës nr. 95, seria PV10K, të shoqërisë “HEC-i Bishnica 1, 2” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 23.3.2010, për prodhimin e energjisë elektrike, me ndryshimin si më poshtë:

- Numri i njësisve gjeneruese:

Ishte: 2 (njësi), me kapacitet të instaluar 2,5 mw.

Bëhet: 3 (njësi), me kapacitet të instaluar 2,5 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet në ERE rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti